



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



Në mbështetje të nenit 64.2 pika (a) dhe (b) dhe neneve 4.5, 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe neneve 4.4, 11.2, 20 dhe 29.2, të Ligjit nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023, miraton këtë:

**RREGULLORE NR. 15/2023**  
**PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME**

**Neni 1**  
**Fushëveprimi**

Kjo Rregullore përcakton afatet kohore për implementimin e aktiviteteve zgjedhore, pas publikimit të datës së zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, kuvendin komunal dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune .

**Neni 2**  
**Vendosja e kushteve dhe afateve kohore**

1. Një ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve të parakohshme, KQZ nxjerr vendim për të caktuar afatet kohore të procedurës zgjedhore:
  - 1.1. Pranimin e ekstraktit të parë të Regjistrimit Civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil;
  - 1.2. përcaktimin e kufizimit të shpenzimeve për fushatë;
  - 1.3. emërimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ);
  - 1.4. publikimin e qendrave të votimit (QV);
  - 1.5. ndërrimin e QV;
  - 1.6. periudhën e kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve;
  - 1.7. periudhën e aplikimit dhe regjistrimit për votim jashtë Kosovës;

- 1.8. deklarimin e koalicioneve për zgjedhje;
- 1.9. certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve;
- 1.10. korrigjimin e listave dhe zëvendësimin e kandidatëve;
- 1.11. tërheqjen shortit për renditje në fletëvotim;
- 1.12. fushatën zgjedhore si dhe afatet për tubimet e fushatës zgjedhore;
- 1.13. regjistrimin dhe votimin e personave me nevoja të veçanta;
- 1.14. emërimin e Këshillave të vendvotimeve (KVV);
- 1.15. periudhën e votimit jashtë Kosovës;
- 1.16. dorëzimin e kërkesave për akreditimi për vëzhgimin e zgjedhjeve;
- 1.17. publikimin e raporteve financiare të fushatës.

### **Neni 3**

#### **Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla Nr.15/2013 për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe zgjedhjet e parakohshme.

### **Neni 4**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

**Kryesues**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

---

**Kreshnik Radoniqi**